



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1254

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi-anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Bora Dental SH.P.K.”, kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Autokllav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror i thithjes për njësite Dentare” me numër të prokurimit; 220/70900-25-8722-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Qendra Klinike Stomatologjike, më 12/02/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE “BORA DENTAL” SH.P.K me nr.2025/0996, e datës 22.12.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Autokllav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror I thithjes për njësite Dentare”, me numër të prokurimit "220/70900-25-8722-1-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Qendra Klin. Stomatologjike.
2. Anullohet, B05 Njoftimi për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën një(1) të vendimit. Autoriteti kontraktues, obligohet të zbatojnë Vendimin e OSHP-se nr.2025/0996,dt.08.10.2025 dhe Raportin e ekspertit shqyrtues nr.2025/1254 te dt.06.01.2026, të përmirësojë kriteret në Dosjen e Tenderit/ Njoftim për Kontratë.
3. Në afat prej 15 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit në Autoritetin Kontraktues i shqiptohet vërejtje për moszbatimin e Vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit me numër 2025/0996. Mos zbatimi i vendimeve të OSHP-së konsiderohet si shkelje e rëndë me Rregulloren për Prokurim Publik Nr. 002/2024 nenin 97 pika h: “Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së”.
5. Operatorit ekonomik OE “BORA DENTAL” SH.P.K , sipas nenit 31 par. 4 të Rregullores OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohen që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto

mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Qendra Klinike Stomatologjike, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 24.09.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Autokllav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror i thithjes për njësite Dentare”, me numër të prokurimit 220/70900-25-8722-1-1-1.

Me datën 15.12.2025, OE “Bora Dental” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk është nxjerr ndërkaq njoftimin për mos shqyrtim të kërkesës për rishqyrtim dt.18.12.2025.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 22.12.2025 operatori “Bora Dental” SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/1254 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111,

paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 06.01.2026 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në ritenderim

Përgjigje e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE ankues “Bora Dental”

Me date 03.10.2025, Operatori Ekonomik ankues Bora Dental SH.P.K ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim kundër njoftimit për kontrate dhe dokumenteve të tenderit të publikuar në platformë të e-prokurimit me date:24.09.2025 ndaj AK-QKSUK, ku pretendimet ankimore kanë qene lidhur me Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale dhe Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Aneksi 1 të DT. Shif dëshminë:

Përmes platformës së e-prokurimit me dt.08.10.2025, AK-ja ka përgatite Vendimin mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim me ane të cilës OE ankues Bora Dental SH.P.K është njoftuar duke lenë në fuqi njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderi të datës 24.09.2025.

Me date: 08.10.2025, Bora Dental SH.P.K ka parashtruar Ankesë në OSHP me pretendimet e njëjta ankimore me lidhje në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme.

Sipas Nenit 108/A të LPP-se edhe OE ankues DUA 5n2 SH.P.K. ka paraqit kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontrate dhe dokumenteve të tenderit lidhje në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme të cilën kërkesë AK-ja e ka refuzuar si të pabazuar në tërësi. Me dt. 03.10.2025 ka parashtruar Ankesë, në OSHP me lidhje në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme. Me poshtë janë dëshmitë e Ankesave në OSHP përmes platformës së e-prokurimit.

Autoriteti kontraktues- QKSUK, konform Pikës 4 të Dispozitivit të këtij Vendimi ka njoftuar OSHP- në se do veprojnë në pajtim me Vendimin ku do përmisoj kriteret e dosjes së tenderit/njoftimit për kontrate dhe do zgjas afatin për ofertim dhe në pajtim të plotë me Rekomandimin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të datës: 02.10.2025.

Zyra e prokurimit me date 11.12.2025 përmes platformës së e-prokurimit ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ku afati për pranim dhe dorëzim të tenderëve është shtyre me date 23.12.2025 ora 12:00 dhe në këtë formular janë bërë edhe përmirësimet e nevojshme sipas vendimit të OSHP-se.

Zyra e prokurimit me date 09.12.2025 ora 13:42 ka ngrit në platforme të e-prokurimit dosjen e tenderit të përmisuar në pajtim të plotë me vendimin e OSHP-se ku kërkesat e kualifikimit apo përzgjedhjes dhe specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi 1 janë përmisuar të cilat janë shenjuar me ngjyre të kuqe në mënyrë që Dosja e tenderit të jetë e qartë për të gjithë Operatorët ekonomik të interesuar.

Zyra e prokurimit me date 09.12.2025 ora 14:06 ka ngrit në platforme të e-prokurimit njoftimin mbi

Rekomandimin e KRPP-së te datës 02.10.2025, duke njoftuar se Rekomandimet janë përmirësuar duke u shenjëzuar me ngjyre te kuqe. Kërkesa për Rishqyrtim te Bora Dental SH.P.K te datës 15.12.2025

Kërkesa për rishqyrtim te OE ankues te datës 15.12.2025 është kundër njoftimit për kontrate dhe dokumenteve te tenderit përkatësisht kundër Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme, te cilat pretendime ankimore janë shqyrtuar ne Vendimin e OSHP-se 2025/0996 te datës 27.11.2025 dhe është obliguar AK-ja te permisoj kriteret e dosjes se tenderit/njoftimit për kontrate dhe te zgjas afatin për ofertim te cilat veprime i ka kryer ne tërësi AK-ja.

Pretendimet ankimore te ankuesit te datës: 15.12.2025 janë te njëjta sikurse ne kërkesën për rishqyrtim te datës 03.10.2025 dhe te cilat nuk mund te shqyrtohen dhe te analizohen nga AK-ja pasi qe për këto pretendime kemi një vendim përfundimtar nga OSHP te cilin e kemi zbatuar.

Pretendimet ankimore te OE ankues mund te paraqiten vetëm kundër njoftimit për kontrate dhe dokumenteve te tenderit te cilën te drejte ligjore e keni shfrytëzuar përmes kërkesës për rishqyrtim te datës 03.10.2025 dhe për te cilin kemi një vendim nga OSHP 2025/0996 te datës 27.11.2025.

Kërkesat për rishqyrtim qe ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit ky afat nuk aplikohet ne rast kur AK-ne bene zgjatjen e afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Refuzimi i kërkesa tuaj si te pabazuar dhe zgjatja e afatit për dorëzim te tenderëve me date 23.12.2025 ne pajtim me Vendimin e OSHP-se, afati për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim sikurse qe keni paraqit me date 15.12.2025 bie ndesh me Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 60 Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore:

Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Pas shtjellimit dhe analizimit te kësaj procedure te prokurimit, ZPP refuzon ne tërësi kërkesën për rishqyrtim si te pabazuar ne kuptim te Nenit 60 Paragrafi 1 Pika a) te Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik dhe mbetet ne fuqi dosja e tenderit e përmirësuar te dt.12.12.2025 dhe B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara te publikuar me date 11.12.2025 ne pajtim me Vendimin e OSHP-se Nr.2025/0981 dhe 2025/0996 te datës 27.11.2025.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Bora Dental” SH.P.K ne ankesën Nr. 1254/2025 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1. OE ankues kërkon rikthimi e kriterit të kapacitetit ekonomik dhe financiar në nivelin dy (2) herë vlere e parashikuar e kontratës, për shkak të ndryshimit të paaautorizuar dhe të pajustificuar të bërë nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e rishpallur të Tenderit.

Pretendimi Ankimor 2. OE ankues kërkohet sqarim dhe rikthim të kriterit të autorizimit në Kërkesën 3 dhe Evidencën 3 të FTD-së, për shkak të ndryshimit të paaautorizuar të bërë nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e rishpallur të Tenderit, në kundërshtim me vendimin e OSHP-së.

Pretendimi Ankimor 3. OE ankues kërkon shfuqizimi e ndryshimit të bërë në Kërkesën 6 dhe Evidencën 6 të FTD-së dhe rikthimi i kriterit për garantimin e pjesëve rezervë për minimum 10 vite. Pasi ulja e kërkesës nga 10 vite në 2 vite përben ulje drastike të standardeve për një projekt të kësaj rëndësie, kërkitimi i pjesëve rezerve vetëm për 2 vite është disproporcional me ciklin jetësor të pajisjeve dhe bie ndesh me praktikën e arsyeshme të prokurimit publik në sektorin shëndetësor.

Pretendimi Ankimor Pyetje 1. Mosrespektimi i vendimit të OSHP-së lidhur me afatet ligjore të ofertimit

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1254/2025, i cili është dorëzuar me datë 06.01.2026.

Lidhur me pretendimet e OE “Bora Dental SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1254 ka vlerësuar si në vijim:

OE BORA DENTAL SH.P.K., aktiviteti i prokurimit me titull “Furnizim me Autokllav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror i thithjes për njësite Dentare” me nr. të prokurimit 220/70900-25-8722-1-1-1.

Autoriteti Kontraktues “Qendra Klinike Stomatologjike” gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë- lloji i kontratës furnizim. Vlora e parashikuar 1,889,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim

me nenin 4, 6, 7, 8, 9, 10, 28, 46, 59, 69, 109 dhe 131 të LPP-së.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë (kriterëve), kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa eksperti shqyrtues/teknik kanë nxjerr raport të ekspertizës me Nr.996/2025, të datës 27.10.2025. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendim PSH.nr. 2025/981-996, i datës 27.11.2025.

Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues/teknik duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa përgjigjen si në vijim. Pas shqyrtimit të plotë dhe të detajuar të dokumentacionit të ofruar për analizë, përfshirë: Ankesën e Operatorit Ekonomik Bora Dental SH.P.K.,2025/1254, Dosjen fillestare të Tenderit, Dosjen e rishpallur të Tenderit dt; 11.12.2025, Vendimin PSH.nr.2025/981-996, i datës 27.11.2025, si dhe Përgjigjen e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1. Ekspertja shqyrtuese/teknike pas shqyrtimit të Dosjes fillestare të Tenderit, Dosjes së rishpallur të Tenderit dhe Vendimit PSH.nr. 2025/981-996, të datës 27.11.2025, konstatohet se ndryshimi i kriterit të kapacitetit ekonomik dhe financiar i bërë nga Autoriteti Kontraktues.

Në Dosjen fillestare, kriteri i kapacitetit ekonomik dhe financiar ishte përcaktuar në nivelin dy (2) herë vlera e parashikuar e kontratës, kriter proporcional me vlerën dhe natyrën e kontratës. Në Dosjen e rishpallur, ky kriter është ulur në vetëm 400,000 euro, vlen të theksohet se nuk ka qenë pretendim ankimore nga ankuesi në herën e parë por as nuk është kërkuar përmes vendimit të OSHP-së, Vendimit PSH.nr. 2025/981-996, i datës 27.11.2025.

Në këtë kontekst, vlerësohet se pretendimi ankimor i OE Bora Dental SH.P.K. lidhur me kriterin e kapacitetit ekonomik dhe financiar është i bazuar. Megjithatë konform nenit 68.1 të LPP-së Gjendja Ekonomike dhe Financiare.

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrësisht në shifra dhe do të referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.....

Përgjigje në pretendimin ankimor 1. Ekspertja shqyrtuese/teknike pas shqyrtimit të Dosjes fillestare të Tenderit, Dosjes së rishpallur të Tenderit, si dhe Vendimit PSH.nr. 2025/981-996, të datës 27.11.2025, konstatohet se ndryshimi i kriterit të autorizimit në Kërkesën 3 dhe Evidencën 3 të Fletës së të Dhënave të Tenderit është bërë sipas vendimit të OSHP-së. Në këtë kontekst, vlerësohet se pretendimi ankimor i OE Bora Dental SH.P.K. lidhur me Kërkesën 3 dhe Evidencën 3 të FTD-së është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1. Ekspertja shqyrtuese/teknike pas shqyrtimit të Dosjes fillestare të Tenderit, Dosjes së rishpallur dhe Vendimit PSH.nr. 2025/981-996, të datës 27.11.2025, konstatohet se Autoriteti Kontraktues në Kërkesën 6 dhe Evidencën 6 të FTD-së, ka ulur afatin e garantimit të pjesëve rezervë nga 10 vite në vetëm 2 vite.

Ekspertja shqyrtuese/teknike sqaron se sipas vendimit të OSHP kërkon të rishikohet mundësia pasi që kriteri prej 10 viteve është shumë i gjatë dhe AK ta rishqyrtojë dhe të vendosë mbështetje nga prodhuesit me afate më të arsyeshme. Në këtë kontekst, vlerësohet se pretendimi ankimor i OE Bora Dental SH.P.K. lidhur me Kërkesën 6 dhe Evidencën 6 të FTD-së, është pjesërisht i bazuar për faktin se Kërkesa e DT se Deklarata nga prodhuesi se do të prodhoj pjesë rezerve edhe për 10 vite e ardhshme. Ndryshimi i kësaj kerkese në dy vite përbën ulje të standardit fillestar të kërkuar çka vlerësohet se do të ndikojë në sigurinë afatgjate të funksionimit të pajisjeve.

Përgjigje në pretendimin ankimor Ekspertja shqyrtuese/teknike pas shqyrtimi të Dosjes së rishpallur të Tenderit dhe Vendimit PSH.nr. 2025/981-996, të datës 27.11.2025, konstatohet se Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së lidhur me respektimin e afateve standarde ligjore të ofertimit. OSHP ka obliguar qartë Autoritetin Kontraktues që, në mungesë të një urgjence reale dhe të paparashikueshme sipas Nenit 46 të LPP-së, të zbatojë afatet standarde ligjore për një kontratë me vlerë rreth 1.9 milion EUR. Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar ekzistencën e ndonjë rrethane të tillë dhe, megjithatë, ka vazhduar të mos sigurojë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave. Ky veprim përbën moszbatim të drejtpërdrejtë i Vendimit PSH.nr. 2025/981-996, të datës 27.11.2025, dhe cenon rëndë parimet e transparencës dhe barazisë në konkurrencë. Në këtë kontekst, vlerësohet se pretendimi ankimor i OE Bora Dental SH.P.K. është i bazuar.

Sa i përket pyetjeve (nga nr.2 deri nr.121) të cilat kanë të bëjnë me specifikime teknike. Ekspertja teknike sqaron se i ka trajtuar në ekspertizën paraprake dhe ekziston një vendim i OSHP.

Megjithatë Dosja e tenderit e datës 11.12.2025 vazhdon të përmbajë kufizime të ngushta, andaj rekomandojmë se autoriteti kontraktues duhet që të hartojë kërkesa të qarta dhe proporcionale me natyrën e aktivitetit që zhvillon, konkretisht gjatë përpilimit të kërkesave apo specifikimeve teknike të vendos pragun minimal dhe maksimal (tolerancën ndërmjet minimumit dhe maksimumit) dhe kurrësi të mos vendosen specifikime teknike fikse ose specifikime teknike që i përshtaten një prodhuesi të caktuar, po ashtu edhe vendimi i OSHP konsideron se AK duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur. AK në dosjen e përmirësuar sipas vendimit të OSHP ka bërë vetëm ndryshime formale dhe selektive, duke ruajtur në thelb strukturën kufizuese të specifikave teknike dhe kriterëve kualifikuese, të cilat janë identifikuar dhe konstatuar nga OSHP si problematike dhe në kundërshtim me parimet e Ligjit të Prokurimit Publik (në rastet kur OSHP lejon që mund të përdoren materialet e ndryshme të një produkt që të mos ketë kufizime, AK nuk e ka lejuar ndryshimin edhe në produkte tjera sa i përket materialit, rezistencës

dhe qëndrueshmërisë së tyre, është kufizuar vetëm në produkte të caktuara, po ashtu tek kamera didaktike OSHP lejon që ajo të jetë e integrueshme në krahun e dritës ngase funksioni është i njëjtë por nuk është dhënë si option nga ana e AK.

Nga krahasimi i specifikimeve me katalogët tregtarë, vërehet përputhje e lartë me produktet e një prodhuesi specifik, çka e bën dokumentin teknik të kufizuar dhe jo konkurues. Kërkesa për riformulim të specifikimeve në mënyrë funksionale, duke mos përmendur dimensione fikse apo materiale të identifikuara me një markë të vetme, është e bazuar dhe në harmoni me parimet e nenit 7 dhe 59 të LPP-së.

Për rrjedhojë, mbetet plotësisht në fuqi mendimi fillestar i ekspertës teknike, sipas të cilit specifikimet duhet të riformulohen në mënyrë funksionale për të garantuar hapje reale të konkurrencës dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Në këtë kontekst, vlerësohet se pretendimi ankimor i OE Bora Dental SH.P.K. është i bazuar.

Pyetje 122. Sistemi qendror i thithjes – specifikime të ngushta

Përgjigje: Ekspertja teknike sqaron specifikimet janë formuluar në mënyrë tepër të ngushtë, duke kufizuar konkurrencën dhe duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë. Kufizimi në konfigurime të paracaktuara nuk lidhet drejtpërdrejt me rezultatin funksional të sistemit të thithjes.

Për rrjedhojë, mbetet në fuqi mendimi fillestar i ekspertës teknike dhe rekomandohet rishkrimi i pozicionit. Pretendimi vlerësohet si i bazuar. Komente mbi instalimin e sistemit qendror të thithjes dhe mungesën e qartësisë teknike.

Kërkesa është formuluar në mënyrë të paqartë dhe teknikisht të papërgatitur, pasi përfshin punime që kërkojnë projektim paraprak, matje në terren dhe analiza strukturore, pa u vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë asnjë e dhënë bazë. Mungesa e informacionit thelbësor (gjatësitë e gypave, rrugët e kalimit, materialet ndërtimore, fuqia elektrike, lejet për shpime) e bën të pamundur përgatitjen e një ofertë reale dhe të krahasueshme.

Kjo qasje bie ndesh drejtpërdrejt me parimin e barazisë në konkurrencë dhe me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili ndalon specifikime të paqarta dhe të paplotësuara. Pyetjet e parashtruara nga operatori ekonomik janë plotësisht të arsyeshme dhe kërkojnë përgjigje të qarta përpara vazhdimin të procedurës. Në mungesë të këtyre sqarimeve, pretendimi ankimor vlerësohet si i bazuar dhe procedura nuk mund të zhvillohet në mënyrë të ligjshme.

Paqartësitë e tilla në dosje të tenderit janë në kundërshtim me nenin 17.12 të Rregullores për Prokurimin Publik sepse kjo dispozitë ligjore përcakton qartë se AK në DT do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë pa kërkuar informata shtesë, informatat e tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që si rregull parimor të mos ketë nevojë për informata

sqaruese shitesë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, për shkak të specifikimeve kufizuese dhe dosjes së tenderit me kërkesa të paqarta teknike (pozicioni 12), ekspertja shqyrtuese/teknike, rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tersi. Ndërsa ankesa operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues nuk është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkah operatori ekonomik nuk është deklaruar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të dhënave më sipër, raporti i ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “BORA DENTAL” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues OE “BORA DENTAL” SH.P.K janë konstatuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues në bazë të kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, si dhe obligimit të Autoriteteve kontraktuese dhe zyrtarëve përgjegjës për zbatimin të ligjit dhe vendimeve të OSHP-se, Paneli konstaton se vendimi i OSHP-së nr.2025/0996 të datës 08.10.2025, nuk

është zbatuar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, i cili ka dështuar të ndërmarrë veprimet e kërkuara për të korrigjuar kriteret e Dosjes së tenderit sipas kërkesave të vendimit të lartcekur. Rregullorja e Prokurimit Publik në nenin 40, paragrafi 40.2.1 ka përcaktuar” ...Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHP-së, rivlerësimi bëhet për të korrigjuar parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së..”

Mos zbatimi i vendimeve të OSHP-së konsiderohet si shkelje e rëndë dhe baze ligjore për iniciimin e procedurës administrative për revokim të certifikatës së zyrtarit përgjegjës të prokurimit sipas Rregullores për Prokurim Publik Nr. 002/2024 nenin 97 pika h: “Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së”.

Për këtë arsye, shqiptohet Vërejtje zyrtare, duke paralajmëruar se përsëritja e shkeljeve të ngjashme mund të rezultojë në kërkesë për marrjen e certifikatës që konsiderohet si mase me e rende disiplinore, në pajtim me rregulloret dhe dispozitat ligjore që rregullojnë përgjegjësinë e personelit në prokurimin publik.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe duke e mbështetur raportin e ekspertit shqyrtues sa i përket vlerësimit të pretendimeve ankimore, por duke e mos mbështetur rekomandimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, për shkak të zvarritjeve që mund të paraqiten pasi aktiviteti ka të bëjë me mjete shëndetësore dhe se qëllim i aktivitetit mund të përmirësohet përmes gjetjeve të këtij vendimi, ka vendosur që ankesa e Operatorit Ekonomik OE “BORA DENTAL” SH.P.K, aprovohet si e bazuar. Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti kontraktues Qendra Klin. Stomatologjike, nuk ka vepruar sipas nenit 51 të LPP-së, dhe nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-se lidhur me përmirsimin e kriterëve të DT/NK.

Paneli Shqyrtues ka vendosur të Anullohet, Njoftimi për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Autoklav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror i thithjes për njësite Dentare”, me numër të prokurimit "220/70900-25-8722-1-1-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Qendra Klin. Stomatologjike, andaj obligohet Autoriteti kontraktues, Qendra Klin. Stomatologjike, të bëjë përmirësimet e kriterëve në Dosje të Tenderit-Njoftimit për Kontratë, sipas vendimit të OSHP-se nr.2025/0919 dhe të gjitha pretendimet ankimore të konstatuara si të bazuara dhe pjesërisht të bazuara sipas Raportit të ekspertit shqyrtues nr.2025/1254 të mbështetura nga Paneli shqyrtues dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas ligjit.

Paneli shqyrtues konstaton se përmirësimi i kriterëve të Dosjes së tenderit/Njoftimit për Kontratë, do të ofrohej mundësi më të madhe për pjesëmarrje të OE-ve në aktivitetin e prokurimit, duke mos dëmtuar apo duke mos ulur cilësinë e produkteve të kërkuara. PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më të madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim dhe në paqëndrueshmëri dhe kundërshtim me dispozitat ligjore.

Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit ankesës të OE “BORA DENTAL” SH.P.K. vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - QENDRA KLIN.STOMATOLOGJIKE**
- **OE - BORA DENTAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: